

Dy OJQ reagojnë për keqtrajtim të homoseksualëve nga SHPK-ja

PRISHTINË, 12 JANAR - Nisma e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut (YIHR), zyra në Prishtinë, si dhe Qendra për Emancipim Shoqëror kanë dënuar fuqimisht të enjten, siç kanë thënë ato, dhunën e ushtruar ndaj dy homoseksualëve shqiptarë nga Kosova, z.L.B. dhe z.G.P. në mëngjesin e 31 dhjetorit të vitit 2005 në Prishtinë.

Në reagimin e përbashkët të këtyre dy OJQ-ve thuhet se dy pjesëtarë të komunitetit homoseksual të Prishtinës janë keqtrajtuar prej policisë ditë më parë.

Sipas reagimit, dhuna e ushtruar është qartë e bazuar në orientimin seksual të z.G.P dhe z.L.B. Pjesëtarët e SHPK-së në vendin e ngjarjes kanë arritur njëzet minuta pas thirrjes që u është bërë nga viktimat. Policia më pas i ka dërguar dy viktimat në Qendrën e Emergjencës. Në vazhdimësi të përcjelljes së procedurës, pjesëtarët e SHPK-së kanë marrë deklaratat e tyre me qëllim të hetimit të mëtejshëm të rastit. Pasi që z.G.P. u tregoi policisë se sulmuesit i sulmuan ata për arsyen të orientimit të tyre seksual, një nga policët iu përgjigj z.G.P. se:

"praktikimi i marrëdhënieve seksuale në mes të gjinive të njëjtë është ilegal". Më tutje, pjesëtarët e SHPK-së nuk kanë respektuar intimitetin e tyre; por duke e treguar orientimin e tyre seksual në Qendrën e Emergjencës kanë shkaktuar diskriminimin e mëtejshmë të viktimateve nga ana e mjekut, duke iu thënë viktimateve që "ju jeni njerëz të sëmurë", bëhet e ditur në reagimin e YIHR-së. Si përfundim, thuhet në reagim, kërkojmë nga Qeveria e Kosovës, UNMIK-u, Shërbimi Policor i Kosovës, si dhe nga subjektet relevante politike të ndërmarrin masa që të parandalojnë diskriminimin ndaj komunitetit të lesbikeëve, homoseksualëve, biseksualëve dhe transgjinorë, si dhe të sjellin kryesit e dhunës para drejtësisë. Më tutje, duam të cekim obligimin që të veprohet në përputhje me Ligjin Kundër Diskriminimit nr.2004/32 të miratuar nga Kuvendi i Kosovës dhe të përkujtojmë që shkelja e ligjit në këtë shoqëri, që është duke u përpjekur të bëhet sa më demokratike, nuk mund të tolerohet, thuhet në reagim.